



Gjatë kursit mësohet krijimi i faqeve të uebit dhe sajtit me gjuhën HTML. Kjo gjuhë është bazë e kodit për të gjitha gjuhët tjera të uebit, prandaj ky kurs është i përshtatshme jo vetëm për fillestarë, por edhe programues profesional me të gjitha shkallëve të diturisë. Të gjitha programet për këtë kurs janë falas.

## Hyrje

- Çka është interneti
- Çka është uebi i gjerë botëror
- Si punon interneti dhe serveri i uebit
- Si tregohet faqja në shfletues të uebit
- Si publikohen faqet pas krijimit

## Përdorimi i imazheve

- Formatet e lejuara në ueb
- Tregimi i imazhit në faqe
- Hiperlidhja me imazh
- Teksti alternativ
- Drejtvendosja në faqe

## Krijimi i faqes së uebit

- Sqarim i etiketave të gjuhës HTML
- Kodi themelor i faqes
- Koka, pjesa qendrore dhe titulli
- Ruajtja e dokumentit në formatin HTML
- Dallimi nga formati për letër
- Pavarësia e dokumentit të uebit nga platforma, programi apo sistemi

## Listat dhe kokrrat

- Krijimi i listës dhe llojet e tyre
- Krijimi i kokrrës dhe llojet e tyre

## Shkronjat

- Si tregohen shkronjat në faqe të uebit
- Dallimi nga dokumenti me përpunues të tekstit, për shembull Word
- Pavarësia e dokumentit të uebit nga platforma, programi apo sistemi

## Tabela

- Sqarim i tabelës
- Krijimi i tabelës
- Qeliza dhe rendi
- Gjerësia, margjina dhe hapësira
- Rrethi: gjerësia, ngjyra dhe lloji
- Drejtvendosja e tekstit në qelizë
- Sfondi me ngjyrë i qelizës ose rendit
- Sfondi me imazh
- Përdorimi i tabelës për pamje të faqes

## Formatimi i tekstit

- Rendi dhe paragrafi
- Kokëzimi
- Madhësia e shkronjës
- Ngjyra e tekstit
- Teksti i trashë dhe i pjerrët

## Shtresat

- Çka janë shtresat dhe dallimi nga programet grafike
- Përdorimi i shtresave për blloqe me përmbajtje
- Përdorimi i shtresave për krijim të pamjes së faqes së uebit

## Hiperlidhjet

- Çka është URL
- Hiperlidhja me faqe tjetër
- Hiperlidhja me shënjes të faqes
- Hiperlidhja me adresë e-postare

## Krijimi i sajtit të plotë të uebit me HTML

- Ushtrime për krijimin e sajtit të uebit
- Publikimi në ueb me FTP (me FileZilla)

Gjatë kursit pjesëmarrësit ushtrojnë me detyra praktike. Ata marrin nga ne udhëzimet me shkrim në gjuhën shqipe, mirëpo librat, **tani për tani**, për këtë kurs janë ende vetëm në gjuhën angleze ose holandeze. Të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtë përkrahje pa pagesë përmes postës elektronike.

Për hollësi kontaktoni në adresën **info@studiotuerta.com** ose vizitoni sajtin **www.studiotuerta.com**.